



Departamenti: Shitje Marketing	Moduli: Menaxhim	Nr: 002
Prof: Blerim Morina	Detyra: Aftesit e menaxherit	
Kompetenca: Identifikimi I aftesive menaxherike	Kohëzgjatja: 20 minuta	Metoda: Grupe (4-5 persona)

RAST STUDIMOR - Katër llojet e aftësive për menaxherë të niveleve të ndryshme

Menaxhmenti i lartë – një menaxher

Menaxhmenti i mesëm – dy menaxherë; nga një menaxher për departament.

Menaxhmenti i ulët – katër menaxherë; nga dy menaxherë për departament.

Kompania “Xona” merret me prodhimin e veshëmbathjeve dhe është në treg të Kosovës që nga viti 2011. “Xona” ka lancuar në treg katër lloje të produkteve (ka segmentuar prodhimin) të cilat janë: këmisha, pantollona, këpucë, dhe patika. Linja e këmishave dhe pantollonave përbënë **departamentin 1** të kompanisë; Linja e këpucëve dhe patikave përbënë **departamentin 2** të kompanisë. Niveli i mesëm i Menaxhmentit në “Xona” ka dy menaxherë; nga një menaxher për departament. Niveli i ulët i menaxherëve në “Xona” posedon 4 menaxherë, nga dy menaxherë për departament.

“Xona” qysh në fillim të operimit ka hasur në probleme të mëdha dhe si rezultat është në diskutim të shuarjës së saj. Sipas të dhënave të dalura nga faza e fundit në Procesin e Menaxhmentit – **KONTROLLI** – identifikohet që “Xona” posedon lloj problemesh të lidhura ngusht me menaxhmentin:

Menaxherët e kompanisë “Xona” dhe roli i tyre në nivelet menaxheriale

Emonda Krasniqi është menaxheri kryesor/ menaxheri i nivelit më të lartë.

Donita Hoxha dhe Arbnor Bytyqi, janë menaxherët e nivelit të mesëm.

Donita – departamenti 1

Arbnori – departamenti 2

Albrim Kilaj, Saranda Paqarizi, Eduard Gashi, dhe Afrora Shala, janë menaxherët e nivelit të ulët.

Albrimi, Saranda – departamenti 1

Eduardi, Afrora – departamenti 2

Smith, Donita, Arbnori, Albrimi, Saranda kanë aftësi të padiskutueshme mbi pesë funksionet e Procesit të Menaxhmentit (Planifikim, Organizim, Personel, Udhëheqje, dhe Kontroll). Në anën tjetër, Eduardi ka vështërsi në motivimin e punëtorëve. Po ashtu analizat përfundimtare mbi kontrollin e punës së kompanisë tregojnë që Afrora 40% të kohës ka deleguar detyrat në mënyrën e gabuar dhe tek personat e gabuar.

Për dallim nga menaxherët e tjerë në “Yark”, Donita dhe Arbnori kanë aftësi të jashtëzakonshme për të ndjerë ndryshimet nga mjedisi, aftësi të tillë për të kuptuar dhe reaguar ndaj ndryshimeve nga mjedisi për të ndërtuar strategji mbrojtëse. Donita vecohet nga të gjithë menaxherët me aftësinë e njohjës së gjendjës së kompanisë në tëresi (njohjen e të gjitha aktiviteteve dhe resurseve në organizatë).

Nga të gjithë menaxherët, Emonda ka të gjitha njohuritë mbi mënyrën e prodhimit të këpucëve dhe patikave, mirëpo ka më pak njohuri mbi prodhimin e këmishave dhe pantollanave. menaxherja Afrora për dallim nga menaxherët e tjerë në “Xona” dallohet për nga dituria e limituar mbi prodhimin e katër produkteve që kompania prodhon.

Pyetje:

- 1. Cfarë problemi posedon Kompania “Xona”?**
- 2. Rendit menaxherët, aftësitë dhe paaftësitë e tyre.**
- 3. Si do të zgjidhni problemin e “Xona”/ cilëve menaxherë do të ju ndërroje pozitën menaxheriale?**

Kohezgjatja 20 minuta

Prezentimi: Te prezantohet para klases nga perfaqsesi I grupi